**R E P U B L I K A   E   S H Q I P Ë R I S Ë**
**BASHKIA DURRËS**
**KËSHILLI BASHKIAK**

# VENDIM

Nr. 43, datë 09.07.2026

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.30, DATË 26.03.2021 "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROCESI I RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR.1032, RRUGA "ALEKS KOMNENI" DHE PALLATIN "KASTRATI", RRUGA "RAMADAN VELIU", TË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019" TË NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", Ligjit nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit", i ndryshuar, si dhe sipas relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.30, datë 26.03.2021 "Për miratimin e listës së përfituesve nga procesi i rindërtimit për pallatin nr.1032, rruga "Aleks

Komneni" dhe pallatin "Kastrati", rruga "Ramadan Veliu", të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019", i ndryshuar, përsa i përket miratimit të sipërfaqeve shtesë nga diferenca në $m^2$, të përfituara nga subjektet përfituese me vendimet përkatëse, sipas listës së subjekteve përfitues me përbërjen familjare, strukturën e apartamentit si dhe $m^2$, hartuar nga Komisioni i Posaçëm, sipas Aneksit 1, dhe kjo listë përbën pjesë integrale të këtij vendimi.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

**KRYETARE**

**Denisa Luarasi**

**U shpall sot me datë 10.07.2026**

**Aneksi 1:** Lista e përfituesve nga procesi i rindërtimit për pallatin nr.1032, rruga "Aleks Komneni" dhe pallatin "Kastrati", rruga "Ramadan Veliu", të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019".

| NR | PRONARI | PËRBËRJA FAMILJARE | STRUKTURA | VKB FITUES | PALLATI | SIP.NE $M^2$ QË DO TË PËRFITOHET |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | DAJANA LUMI | 4 | 2+1 | 76 DT 28.06.2021 | PALL KASTRATI, RAMADAN VELIU | 109 |
| 2 | ILIA TRAJA, MERITA TRAJA | 2 | 1+1 | 120 DT 30.09.2021 | PALL KASTRATI, RAMADAN VELIU | 68 |
| 3 | MENTOR MUJA | 4 | 2+1 | 76 DT 28.06.2021 | PALL KASTRATI, RAMADAN VELIU | 125 |
| 4 | LIRIM MURRJA, SHADIJE ZILI | 5 | 3+1 | 30. DT 26.03.2021 | PALL KASTRATI, RAMADAN VELIU | 100 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

**Nr.** 537/9 **prot.** **Durrës, më** 15 . 07 **.2026**

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

BASHKIA DURRES
17/7/26 9260/8 PROT

**KËSHILLIT BASHKIAK**
**DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË**
**DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.43 datë 09.07.2026, "Për miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.30, datë 26.03.2021 "Për miratimin e listës së përfituesve nga procesi i rindërtimit për pallatin nr.1032, rruga "Aleks Komneni" dhe pallatin "Kastrati", rruga "Ramadan Veliu", të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019" të ndryshuar".

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 "Kodi e Administrative", pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" (neni 8/a) i ndryshuar "Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore".

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karkater individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**ADRIAN GURRA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT DURRËS